



Бр/№. _____
Скопје/Shkup _____ година/viti

Në bazë të nenit 37-i të Ligjit për ndërmarrjet publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 38/1996; 9/1997; 6/2002; 40/2003; 49/2006; 22/2007; 83/2009; 97/2010; 6/2012; 119/2013; 41/2014; 138/2014; 25/2015; 61/2015; 39/2016; 64/2018 dhe 35/2019 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 275/2019, 89/2022 dhe 274/2022) dhe neni 22-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016, 35/2018 dhe 198/2018 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.143/2019 dhe 14/2020) dhe neni 3 të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike, fletëparaqitja për punësim dhe mënyra e realizimit të selektimit për punësimin e ofruesve të shërbimeve publike në Ndërmarrjen publike për Rrugë Shtetërore numër 02-12763/7 të datës 25.11.2019, Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore, me seli në rr. “Dame Gruev” numër 14, në Shkup shpall

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR 4/2023

për punësim në kohë të pacaktuar të ofruesve të shërbimeve publike në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore për vendet e punës në vijim

1. KDR0305B01090 Këshilltar për kontroll të komunikacionit në Njësinë për kontroll të komunikacionit, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesës të taksës rrugore -2 (dy) realizues, me plotësimin e kushteve të veçanta:

- Së paku 180 kredit të fituara sipas SEKT ose shkalla e VIB të mbaruar të arsimit në fushën e Makinerisë, Trafik dhe transport, Elektroteknik
- Përvoja e punës – së paku tre vjet përvojë pune në profesion
- Orari i punës ndahet në tre ndërrime dhe zgjat 8 orë, edhe atë ndërrimi i parë nga ora 06:00 deri orën 14:00, ndërrimi i dytë nga ora 14:00 deri në orën 22:00 dhe ndërrimi i tretë nga ora 22:00 deri në orën 06:00
- Punë gjatë festave dhe punë nate
- Vendi i kryerjes së detyrave të punës është në Pikën kontrolluese Negotinë
- Koha javore e punës është 40 orë
- Paga bazë është 42.360,00 denarë

Gjatë përzgjedhjes kanë përparësi kandidatët të cilët kanë të kaluar trajnimin për SKADA dhe CCTV Sistemi.

VËREJTJE: Sipas planit vjetor të institucionit për vitin 2023, punësimet parashikohet për : 1 (një) rom(e), 1 (një)- shqiptar(e).





2. KDR0305B03065 Udhëheqës ndërimi për pagesë të taksës rrugore në Njësinë për pagesë të taksës rrugore dhe kontrollë, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesë të taksës rrugore -3 (tre) realizues, me plotësimin e kushteve të veçanta:

- - Niveli më i ulët i kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose SKMAP, ose arsimiti i mesëm katërvjeçar
- Përvoja e punës – së paku një vite përvoj pune në profesion
- Orari i punës ndahet në dy ndërrime dhe zgjat 12 orë, nga ora 07:00 deri në orën 19:00 dhe nga ora 19:00 deri në orën 07:00
- Vendi i kryerjes së detyrave të punës është Pikat pagesore në RMV
- Punë gjatë festave dhe punë nate
- Koha javore e punës është 40 orë
- Paga bazë është 27.600,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor të institucionit për vitin 2023, punësimet parashikohet për : 2 (dy) shqiptar(e), 1 (një)- turk(e).

3. KDR0305B03131 Kontrollor për kontrollim video monitorim në Njësinë për pagesë të taksës rrugore dhe kontroll, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesës të taksës rrugore -1 (një) realizues, me plotësimin e kushteve të veçanta:

- Niveli më i ulët i kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose SKMAP, ose arsimiti i mesëm katërvjeçar
- Përvoja e punës – së paku një vjet përvojë pune në profesion
- Orari i punës është caktuar në një ndërrim dhe gjatë 8 orë
- Orari i punës është fleksibël sipas orarit ditor ose javor të aktiviteteve të përgatitura nga Udhëheqësi
- Vendi i kryerjes së detyrave të punës është Qendra kontrolluese Petrovec
- Punë gjatë festave dhe punë nate
- Koha javore e punës është 40 orë
- Paga bazë është 34.320,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor të institucionit për vitin 2023, punësimet parashikohet për: 1 (një) shqiptar(e)





4. KDR0305B02076 Përgjegjës për pagesë të taksës rrugore në Njësinë për pagesë të taksës rrugore dhe kontroll, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesës të taksës rrugore -1 (një) realizues, me plotësimin e kushteve të veçanta:

- Niveli më i ulët i kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose SKMAP, ose arsimiti i mesëm katërvjeçar
- Përvoja e punës – së paku dy vjet përvojë pune në profesion
- Orari i punës ndahet në një ndërrim dhe zgjat 12 orë
- Orari i punës prej orës 07.00 deri orës 19.00
- Vendi i kryerjes së detyrave të punës është Stacionet pagesore në RMV
- Punë gjatë festave
- Koha javore e punës është 40 orë
- Paga bazë është 29.700,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor të institucionit për vitin 2023, punësimet parashikohet për: 1 (një) – shqiptar(e),

5. KDR0305B02038 Koordinator për pagesë të taksës rrugore në Njësinë për pagesë të taksës rrugore dhe kontroll, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesës të taksës rrugore -1 (një) realizues, me plotësimin e kushteve të veçanta:

- Niveli më i ulët i kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose SKMAP, ose arsimiti i mesëm katërvjeçar
- Përvoja e punës – së paku dy vjet përvojë pune në profesion
- Orari i punës është caktuar në një ndërrim dhe zgjatë 8 orë
- Koha javore e punës është 40 orë
- Puna në ditët e punës – nga e hëna deri të premten
- Orari i punës prej orës 7,30/8.30 deri në orën 15.30/16.30
- Vendi i kryerjes së detyrave të punës është Qendra kontrolluese Petrovec
- Punë gjatë festave dhe punë nate
- Paga bazë është 35.040,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor të institucionit për vitin 2023, punësimet parashikohet për: 1 (një) – shqiptar(e),





Përkundër kushteve të veçanta të përmendura, të parashikuara me Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore nr.02-11513/1 të datës 29.11.2017, nr. 02-4102/1 të datës 02.04.2018, nr.02-8770/1 të datës 13.08.2019 dhe 02-11571/1 të datës 29.11.2019, numër 02-12413/1 të datës 02.12.2020, numër 02-1826/1 të datës 19.02.2021, numër 02-5788/1 të datës 04.06.2021, numër 02-2299/1 të datës 08.03.2022, numër 02-7329/1 o të datës 25.07.2022, numër 02-2601/1 të datës 17.03.2023 dhe numër 02-7047/1 të datës 25.07.2023, kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme për punësim të parashikuar me nenin 37-zh të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 38/1996; 9/1997; 6/2002; 40/2003; 49/2006; 22/2007; 83/2009; 97/2010; 6/2012; 119/2013; 41/2014; 138/2014; 25/2015; 61/2015; 39/2016; 64/2018 dhe 35/2019 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 275/2019, 89/2022 dhe 274/2022) dhe Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore nr. 02-11513/1 të datës 29.11.2017, nr. 02-4102/1 të datës 02.04.2018, nr.02-8770/1 të datës 13.08.2019 dhe 02-11571/1 të datës 29.11.2019, numër 02-12413/1 të datës 02.12.2020, numër 02-1826/1 të datës 19.02.2021, numër 02-5788/1 të datës 04.06.2021, numër 02-2299/1 të datës 08.03.2022, numër 02-7329/1 o të datës 25.07.2022, numër 02-2601/1 të datës 17.03.2023 dhe numër 02-7047/1 të datës 25.07.2023 edhe atë:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive ta përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- të mos ketë të shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm për ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kompetencat e përgjithshme të punës

- zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve për çështjet brenda fushëveprimit të vet;
- mësim dhe zhvillim;
- komunikim;
- arritja e rezultateve;
- puna me tjerë/puna ekipore;
- ndërgjegjësim strategjik;
- orientimi drejt klientit/palëve të interesuara; dhe
- menaxhimin financiar.

Me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës jo më i vjetër se 6 (gjashtë) muaj),





- Vërtetim/Dëshmi për përvojë pune
- Certifikatë/Diplomë për nivelin e arsimimit të mbaruar,
- Vërtetim mjekësor për aftësi të përgjithshme shëndetësore, jo më i vjetër se 1(një) vjet,
- Certifikatë e shtetësisë

Dëshmitë për përmbushjen e kushteve duhet të jetë në formën origjinale ose një kopje e vërtetuar nga një noter.

Kushtet e përcaktuara në konkurs, duhet të plotësohen nga kandidatët në kohën e aplikimit.

Punësimi do të jetë me kohë të pacaktuar.

Afati i paraqitjes së kandidatëve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, i llogaritur nga dita e nesërme nga dita e publikimit të konkursit publik në gazetata ditore (pa llogaritur vetë ditën e publikimit).

Person për kontakt Biljana Cvetkoviq.
Kontakt telefoni 02/3118- 044.

Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë për punësim duke paraqitur një fletëparaqitje për punësim (FLETËPARAQITJA MUND TË SHKARKOHET UEB FAQJA E NP PËR RRUGË SHTETËRORE www.roads.org.mk OSE NGA ZYRJA PËR FLETËPARAQITJE NË NP PËR RRUGË SHTETËRORE) me të dhëna kontakti dhe dokumente/dëshmi të përmbushjes së kushteve për punësim në adresën e Ndërmarrjes Publike: NDËRMARRJE PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE "Dame Gruev" nr. 14 , 1000 Shkup ose në sportelin e Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, me përcaktimin "për shpalljen publike me numër 4/2023 për punësim për një periudhë të pacaktuar të ofruesve të shërbimeve publike në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore".

KANDIDATËT JANË TË OBLIGUAR NË FLETËPARAQITJE DETYRIMISHT TË THEKSOJNË NUMRIN E KONKURSIT QË KONKUROJNË DHE PËR CILIN VEND TË PUNËS APLIKOJNË .

Kandidatët duhet të plotësojnë fletëparaqitjen në mënyrë të plotë, të saktë, me të dhëna të sakta dhe një deklaratë të dhënë nën përgjegjësinë materiale dhe penale me të cilën kandidati konfirmon se të dhënat e fletëparaqitjes janë të sakta, ndërsa dëshmitë e dorëzuara janë origjinale ose kopje e besueshme origjinale.

Kandidatët që nuk e paraqesin kërkesën në fjalë, të cilët nuk do ta plotësojnë atë plotësisht ose nuk do të tregojnë numrin e reklamës dhe punën për të cilën po aplikojnë, do të konsiderohen të çrregullt.





Dokumentacioni i pakompletuar dhe jo në kohë nuk do të merret parasysh gjatë shqyrtimit të fletëparaqitjeve.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve do të kryhet nga Komisioni për selektim për punësim të ofruesve të shërbimeve publike të formuar nga ana e Drejtorit të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, e cila konsiston në kontrollin e të dhënave të regjistruara në fletëparaqitjet për punësim me kushtet e përcaktuara në konkursin publik, kontrollin e provave të bashkëlidhura në fletëparaqitje dhe intervistën brenda afatit të mëposhtëm:

Faza 1 – kontrolli i të dhënave të futura në fletëparaqitje : Në afat prej 10 ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e kandidatëve

Faza 2 – verifikimi i provave në fletëparaqitje: Në afat prej 10 ditëve nga kryerja e verifikimit të të dhënave të fletëparaqitje

Faza 3 – intervista – në afat prej 10 ditëve nga verifikimi i provave të bashkangjitura në fletëparaqitje

Pas mbarimit të procedurës së selektimit të kandidatëve, për përzgjedhje e bërë secili kandidat do të njoftohet me shkrim.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore

